



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjiçan
Gilan Belediyesi

Në bazë nenit 18 parag. 1 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Nr.03/L-149, lidhur me neni 15 parag. 1 dhe 2 të Rregullores për Procedurat e Rekrutimit, Njësia për personel në mbështetje të kërkesës së aprovuar nga MAP-DASHC për fillimin e rekrutimit nr. i ref. 04/560 të dt;18.04.2013 shpall :

K o n k u r s

Për plotësimin e vendeve të punës:

1. Agjencioni për Menaxhimin e Emergjencave/MPB (me autorizim) Njësia Profesionale e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit-Gjiçan

Titulli i pozitës : **Zjarrfikës profesional**

Nr. i ekzekutuesve 1 (një)

Numri i referencës : **01/2013**

Grada / Koeficienti:5.5

Lloji i emërimit : **I KARRIERËS, Zbatohet periudha provuese prej dymbëdhjetë (12) muajve**

Orari i plotë : **40 orë në javë**

Detyrat dhe përgjegjësit :

- Drejtprësdrejt merr pjesë në shuarjen e zjarrit,shpëtimin e jetës së njerëzve dhe pasurisë si dhe në fatkeqësitë tjera elementare,
- Kryen shërbimin e kujdestarisë në ndërrimin e vetë dhe pranon lajmërimin e zjarreve dhe fatkeqësive tjera,
- Punon me ndërrime në gjendje gatishmërie në orar të punës dhe jashtë orarit sipas nevojës,
- Merr pjesë në rregullimin e mjeteve dhe pajisjeve zjarrfikëse si dhe zbaton masat preventive të mbrojtjes nga zjarri,
- Merr pjesë në gara të zjarrfikësve dhe shpëtimit si dhe ushtrimet publike,
- Në raste zjarri dhe fatkeqësive elementare punon me pompë motorike duke u kujdesur edhe për pajisjet personale e të përbashkëta,
- Kujdeset për mirëmbajtjen e stacionit të zjarrfikësve,
- Merr pjesë në trajnime dhe ligjërata me interes për NJPZSH,
- Në orar të punës nuk guxon të merret me punë tjera dhe është i obliguar që oficerët me gradë më të lartë të i përshëndes,
- Gjatë kujdestarisë kontrollon çdo hyrje e dalje në lokalet e NJPZSH dhe ndalon hyrjen e të pa punëve në to,
- Punon me ndërrime dhe gjatë orarit të punës në stacion obligohet të bartë uniformën e punës.

Kushtet për punësim:

- të jetë nën moshën 30 vjeçare
- të ketë të kryer shkollën e mesme;
- të ketë aftësi psiko-fizike për të kryer aktivitetet e zjarr-fikjes dhe shpëtimit;

-të mos jetë i ndjekur penalisht.
-të ketë përvojë pune 1 vit si zjarrfikës,
-certifikata mbi trajnimet profesionale të zjarr-fikjes dhe shpëtimit dhe kushtet tjera sipas ligjit për Mbrojtje dhe Shpëtim nr.04/L-049.

2. Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje të Mjedisit

Titulli i pozitës : **Zyrtar-Arkivist**

Nr. i ekzekutuesve **1 (një)**

Numri i referencës : **02/2013**

Grada / Koeficienti:5

Lloji i emërimit : **I KARRIERËS, Zbatohet periudha provuese prej dymbëdhjetë (12) muajve**

Orari i plotë : **40 orë në javë**

Detyrat dhe përgjegjësitë:

-kryen të gjitha punët e pranimi, evidentimit, distribuimit, ekspeditimit intern dhe ekstern të lëndëve;
-operon me protokoll elektronik inert;
-bën klasifikimin, radhitjen, ruajtjen dhe arkivimin e lëndëve, kërkesave dhe postës drejtuar drejtorisë;
-mban evidencën sipas llojit të kërkesës, kohës së pranimi, lëvizjes, përfundimit dhe kthimit të kërkesave-lëndëve dhe paraqet raport mbi ecurit e tyre;
-kujdeset për përdorimin e vulave dhe ruajtjen e tyre;
-paraqet raporte periodike lidhur me punën e tij;
-kryen edhe punë të tjera të caktuara me ligj nga fushëveprimi i drejtorisë në kuadër të kualifikimit.

Kushtet për punësim:

- të ketë të kryer shkollën e mesme;
- të ketë 1 vit përvojë pune
-të njoh punën me kompjuter, përkatësisht programin e menaxhimit të të dhënave.
-të ketë trajnime të ndryshme,
-aftësi komunikuese dhe të punoj në grup

Çdo kandidat (aplikues) për pozitën e lartëcekur duhet t'i kompletoj dhe dorëzoj dokumentacionin e domosdoshëm (kopje) si vijon :

1. Dëshmi të kualifikimit shkollorë,
2. Dëshmi mbi përvojën e punës,
3. Certifikatat për trajnime dhe njohje të punës me kompjuter,
4. Dokumentin e identifikimit
5. Certifikatën se nuk është nën hetime dhe se nuk është i dënuar për ndonjë vepër penale
6. Certifikatën mjekësore për punësim origjinal

Aplikacionet merren dhe të plotësuara dorëzohen në arkivin qendror të Komunës së Gjilanit, përkatësisht në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve
Afati i aplikimit është 15 ditë, nga dita e shpalljes publike në gazet dhe në mjetet e tjera të informimit publik.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen për testim dhe intervistë. Shërbimi Civilë i Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale.

Aplikacionet e dorëzuara pas afitit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.